



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.19/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Urban Lift” shpk, me numër identifikues 810855265, me seli ne Prishtinë, te cilin e përfaqëson sipas autorizimit B.B. avokat nga Suhareka, ndaj debitorit “Kosovo Endocrine Group”, shpk, me numër identifikues 811475723 me seli ne Ferizaj, Talinoc i Jerlive, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkalles se Parë KPPP.nr.2242/22 dt.25.10.2023, me datën 20.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. Refuzohet e pabazuar ankesa e debitorit “Kosovo Endocrine Group”, shpk, me numër identifikues 811475723 me seli ne Ferizaj, Talinoc i Jerlive, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkalles se Parë KPPP.nr. 2242/22 dt.30.10.2023, Vërtetohet.
- II. Mbetet e pashqyrtuar pika I (Një) e dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkalles se Parë, KPPP.nr. 2242/22 dt.25.10.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës–Dhomat e Shkalles se Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 2242/22 dt.25.10.2023, ne pjesën e I te dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit “Kosovo Endocrine Group”, shpk, me numër identifikues 811475723 me seli ne Ferizaj, Talinoc i Jerlive dhe ka anuluar pjesërisht urdhrin përmbartimor P.nr.51/22 dt.08.09.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Arben Gashi, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë, për pjesën e shpenzimeve për përpilimin e propozimit për përmbartim mbi shumen prej 104.00 euro. Ne pjesën e II te dispozitivit te aktvendimit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit “Kosovo Endocrine Group”, shpk, me numër identifikues 811475723 me seli ne Ferizaj, Talinoc i Jerlive, sa i përket borxhit kryesor ne lartësi prej 8,000.00 euro si dhe shpenzimeve ne emër te përpilimit te propozimit për përmbartimin ne vlerë prej 104.00 euro dhe ne këtë pjesë urdhri përmbartimor P.nr.51/22 dt.08.09.2022 i lejuar nga përmbartuesi privat Arben Gashi mbetet ne fuqi. Ne pjesën e III te dispozitivit te këtij aktvendimi, detyrohet debitori qe ne emër te shpenzimeve te përpilimit te

përgjigjes ne prapësim t'ia paguaj kreditorit shumen prej 104.00 euro, ne afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori, pa precizuar bazat e veçanta ligjore, me propozim qe gjykata e shkallës se dytë ta hedh poshtë aktvendimin e atakuar.

Përgjigje ne prapësimin e debitorit ka ushtruar kreditori me arsyetimin se nuk janë plotësuar asnjë nga shkaqet për ushtrimin e prapësimin, propozon qe gjykata e shkallës se dytë ta refuzoj ankesën e debitorit, te mbetet ne fuqi urdhri përmbartimor dhe te detyrohet debitori qe kreditorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës sipas Tarifës se Odes se Avokateve për përpilim te propozimit për përmbartim dhe përgjigjes ne prapësim, ne shumen prej 208 euro.

Dhoma e Shkallës se Dytë e Gjykatës Komerciale, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori "Urban Lift" shpk, me numër identifikues 810855265, me seli ne Prishtinë, me datën 08.09.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit "Kosovo Endocrine Group", shpk, me numër identifikues 811475723 me seli ne Ferizaj, Talinoc i Jerlive, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës me nr.10/2021 dt.18.03.2021. Përmbartuesi Privat Arben Gashi nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.51/22 dt.08.09.2022, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit qe rrjedh nga fatura t'ia paguaj shumën prej 8,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% deri ne pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori, me datën 21.09.2022 ka paraqitur prapësim, me pretendimin se fatura është lëshuar ne fillim pa nisur punët dhe asnjë punim tjetër, ka keqpërdorë besimin tonë ku shihet edhe ne dokumentin përmbartues nuk i ka paraqitur mjetet qe ia kemi paguar kesh. Nga frika dhe vonesat që shkaktoi kreditori ne kemi hezituar te bëjmë pagesa sepse kishim edhe një kontratë të nënshkruar ligjërisht qe na obligon qe pa u bërë ekzekutimi me rregull i punëve dhe dorëzimi i dokumenteve mbi kryerjen e punëve nga ana e kreditorit te mos bëjmë pagesa. Kreditori nuk e ka përfillë asnjë nen te kontratës sepse ashensori i kontraktuar nuk ka qenë i montuar si duhet dhe i njëjti nuk është përgjigjur për ta rregulluar sipas vërejtjeve, propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, urdhrin përmbartimor ta anuloj dhe ta obligoj debitorin ti bartë shpenzimet e procedurës.

Përgjigje ne prapësimin e debitorit me datën 26.09.2022, ka ushtruar kreditori, me arsyetimin se sipas kërkesës se debitorit i ka shitur ashensorin sipas kontratës dt.18.03.2021 me nr.07/2021 e

cila vërtetohet përmes faturës se lëshuar nga kreditori, konform nenit 22 dhe 29 të LPP, kreditori ka filluar procedurën përmbartimore pasi që debitori nuk është përgjegjës në kryerje të pagesës së vlerës e cila ka arritur për pagesë konform kontratës për shitjen e ashensorit, propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit, urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi dhe të detyrohet debitori të paguaj shpenzimet e përpilimit të përgjegjës në prapësim në shumën prej 208 euro.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkalles së Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjegjës në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.2242/22 dt.,25.10.2023, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi pjesërisht urdhrin përmbartimor, si dhe ka refuzuar pjesërisht prapësimin dhe ka lënë në fuqi pjesërisht pjesën tjetër të urdhrin përmbartimor, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata i referohet nenit 29 par.1 dhe par.3 të LPP, se fatura nr.10/2021 dt.18.03.2021 i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm në kuptim të nenit të lartcekur, fatura i është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga kreditori debitorit, i njëjti e ka vëlosur dhe nënshkruar, ashtu që e njëjta plotëson kushtet e përcaktuara nga neni 37 i LPP për zbatim të përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm. Gjykata ka vlerësuar edhe për pretendimin e debitorit se një pjesë e borxhit në lartësi prej 4,350.00 euro është përmbushur me para në dorë por i njëjti është i pabazuar ngase debitori nuk ka ofruar prova dhe dëshmi të vlefshme për ta mbështetur një pretendim të tillë në kuptim të nenit 69 par.4 të LPP. Sa i përket pretendimit të debitorit në lidhje me të metat e ashensorit, vlerësoj se ky pretendim nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit në këtë procedurë sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigozitetit formal në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera. Gjykata ka shqyrtuar urdhrin përmbartimor P.nr.51/2022 dt.08.09.2022 sa i përket obligimit të debitorit për pagesën e shpenzimeve në shumën prej 208 euro për përpilim të propozimit për përmbartim sipas tarifës së OAK por konstatoi se shumën prej 208 euro nuk është në përputhje me rregulloren në fuqi për tarifën e avokateve dt.18.03.2017 të OAK ngase tarifa për përpilimin e parashtrësive në procedurën përmbartimore në bazë të dokumentit të besueshëm në vlerë mbi lartësinë e kontestit të vlerës së vogël është shumën prej 104 euro, andaj gjykata shfuqizoi urdhrin përmbartimor sa i përket kësaj pjesës. Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit konform nenit 463 dhe 453 të LPK, nenit 17 dhe 13 të LPP duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes.

Gjykata e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Konsideron se fatura nr.10/21 dt.18.03.2021 mbi bazën e të cilës është lejuar

përbarimi plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm konform nenit 29 par.3 te LPP i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar*“ . Neni 37 të LPP-së thotë se “*kur propozimi për përbarim paraqitet ne bazë te dokumentit te besueshëm, mjafton qe propozimit ti bashkëngjitet dokumenti i tillë ne origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”, si edhe Udhëzimi Administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili ne nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh qe “*Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore*”, e qe ne këtë rast rezulton se kjo faturë si e tillë është e përshtatshme për përbarim, sepse është e nënshkruar nga debitori dhe e vulosur nga i njëjti dhe se propozimit për përbarim i është bashkëngjitur ne kopje por te noterizuar, e njëjta konsiderohet se është e pranuar ne mënyrë te rregullt dhe është e përshtatshme për tu ekzekutuar.

Kjo gjykatë i analizoi pretendimet e palës debitore se një pjesë e borxhit ne lartësi prej 4,350.00 euro është paguar por vlerësoi se është fakt se ne lëndë gjenden disa pagesa por qe nga te njëjtat nuk mund te vërtetohet fakti se këto pagesa kanë te bëjnë me faturën nr.10/21 dt.18.03.2021 mbi bazën e te cilës është lejuar përbarimi dhe me çështjen konkrete. Ndërsa sa i përket pretendimit te debitorit ne lidhje me te metat e ashensorit, edhe kjo gjykatë vlerëson se kjo çështje nuk mund te jetë objekt i shqyrtimit te procedurës përbarimore pasi kjo procedurë mbi bazën e parimit te rigorozitetit formal ka për bazë vetëm vlerësimin e dokumentit te besueshëm mbi bazën e te cilit është lejuar përbarimi. Pra, marrë parasysh parimin e rigorozitetit formal, në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin, ndërsa për realizim te këtyre pretendimeve kjo gjykatë udhëzon palën debiore ne procedura tjera siç është ajo kontestimore. Gjykata e shkalles se dytë ka vlerësuar dhe pranuar edhe përfundimin juridik te gjykatës se shkallës se parë ne lidhje me shpenzimet e procedurës bazuar ne nenin 463 dhe 453 te LPK, andaj edhe aktvendimin e shkalles se parë e vërtetoj.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Gjykata ka vendosur sikurse në pikën II (dy) të këtij aktvendimi, pasi që pika I (një) e aktvendimit të ankimuar, nuk kanë qenë objekt ankimit, pasi pala kreditore nuk ka ushtruar ankesë, ndërsa pala debitore nuk ka interes juridik që aktvendimi të goditet në pjesën aprovuese, andaj në këtë pjesë ka mbetur i pa shqyrtuar.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II.nr.19/24, datë 20.02.2024

Gjyqtari
Ramush Bardiqi